FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

TUSIPEKTOL

SHURUP
100 g (Kodeinë Fosfat Hemihidrat, Benzaldehid, Ekstrakt Fluid Balsam Toluje, Ekstrakt i Lëngshëm Timusi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Tusipektol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Tusipektol
3. Si ta merrni Tusipektol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Tusipektol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË TUSIPEKTOL DHE PËRSE PËRDORET

Tusipektol përmban si lëndë aktive kodeinë fosfat, benzaldehid, ekstrakt balsam Toluje dhe ekstrakt timusi.
Kodeina frenon qendrën e kollës duke qetësuar kollën me origjinë të ndryshme. Kodeina dhe kripërat e saj, kryesisht fosfati, përdoren nga goja në trajtën e shurupeve për qetësimin e kollës.
Ekstrakti i timusit dhe balsami i Tolusë janë përbërës bimorë me veti mukolitike, të cilët ndihmojnë në lehtësimin e kollës.

Tusipektol - shurup indikohet:
- si mjet ndihmës në sëmundjet akute dhe kronike të frymëmarrjes si: kollë me origjinë të ndryshme (nga gripi, ose ftohje), bronkit, laringit.

2. PËRPARA SE TË MERRNI TUSIPEKTOL

Mos merrni Tusipektol në qoftë se:
- keni mbindjeshmëri ndaj kodeinës, lëndëve të tjera aktive ose ndonjë prej përbërësve të tjerë të këtij produkti mjekësor;
- jeni nën 18 vjeç;
- jeni metabolizues shumë të shpejtë të kodeinës;
- vuani nga astma;
- keni insufiçiencë të frymëmarrjes;
- keni kollë me sekrecione viskoze.

Të evitohet përdorimi i zgjatur dhe me doza të larta në rastet e konstipacionit kronik.
Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos merrni Tusipektol, por konsultohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna prej tij.

Tregoni kujdes të veçantë me Tusipektol
Njoftoni mjekun tuaj në rast se:
- vuani nga çrregullimet e funksionit të mëlçisë ose të veshkave;
- jeni një person me të dhëna për përdorim abuziv të lëndëve narkotike;
- keni rritje të presionit intrakranial, hipovolemi dhe konvulsione me origjinë qëndrore;
- jeni duke u trajtuar me një preparat tjetër për kollën ose ftohjen, sepse preparate të ndryshme mund të përmbajnë të njëjtat lëndë aktive duke shkaktuar mbidozim;
- keni intolerancë nga disa sheqerna.

Tusipektol përmban alkool etilik (etanol 96%), prandaj duhet treguar kujdes i veçantë në gratë shtatzëna, laktacion (në këto raste nuk rekomandohet!) dhe pacientët me rrezikshmëri të lartë si p.sh. ata me insufiçiencë hepatike dhe epilepsi. Alkooli etilik (etanol 96%) është i dëmshëm për personat që vuajnë nga alkoolizmi.

Marrja e barnave të tjera
Kodeina mund të fuqizojë efektin e agonistëve të tjerë opioidë, analgjezikëve të përgjithshëm, qetësuesve, hipnotikëve, antidepresivëve triciklikë, frenuesve të MAO-s, alkoolit dhe depresantëve të tjerë të SNQ-së.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji
Nuk rekomandohet përdorimi i Tusipektol gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Duhet të tregohet kujdes në përdorimin e Tusipektol duke qenë se kodeina ndikon në aftësinë për të drejtuar automjetin ose përdorur makineritë.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Tusipektol
Tusipektol - shurup përmban metilhidroksibenzoat, i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).
Ky produkt përmban alkool etilik (etanol 96%). Alkooli etilik është i dëmshëm për personat që vuajnë nga alkoolizmi. Gjithashtu duhet treguar kujdes i veçantë tek pacientët me rrezikshmëri të lartë si p.sh. ata me insufiçiencë hepatike dhe epilepsi.
Ky bar përmban sukrozë (sheqer). Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI TUSIPEKTOL

Ndiqni gjithmonë këshillat e mjekut ose farmacistit tuaj në lidhje me dozat e Tusipektol që duhet të merrni dhe shikoni gjithnjë udhëzimet e përshkruara në këtë fletëudhëzues.

Dozimi është:

Kategoria	Dozimi	Koha e marrjes
Të rriturit mbi 18 vjeç	15 ml	3 herë në ditë; 1 - 2 orë pas ushqimit dhe para gjumit

Në qoftë se keni marrë më shumë Tusipektol:
Mos merrni më shumë Tusipektol sesa duhet. Nëse keni marrë më shumë Tusipektol se sasia e duhur, ju lutemi konsultohuni me mjekun ose shkoni në spital për të marrë ndihmën e nevojshme.

Në qoftë se keni harruar të merrni Tusipektol:
Në qoftë se harroni të merrni Tusipektol, merrni dozën tuaj sa më shpejt që të kujtoheni përveç rastit kur ka ardhur koha që të merrni dozën pasardhëse. Përdorni dozat në kohën e duhur.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Tusipektol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Efektet anësore të mundshme janë:
- konstipacion, kur përdorimi është i zgjatur dhe me doza të larta;
- nauze dhe të vjella;
- frymëmarrje e vështirësuar;
- eritemë dhe prurit në rastet e mbindjeshmërisë ndaj barit.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI TUSIPEKTOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Tusipektol pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni në temperaturë më të ulët se 25°C!
Ruajeni Tusipektol nga dielli dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Tusipektol:
Lëndët vepruese janë:
kodeinë fosfat hemihidrat, benzaldehid, ekstrakt fluid balsam Toluje dhe ekstrakt i lëngshëm Timusi.
1 gram shurup përmban: 0.6 mg kodeinë fosfat hemihidrat, 0.08 mg benzaldehid, 40 mg ekstrakt fluid balsam Toluje dhe 90 mg ekstrakt i lëngshëm Timusi.

Përbërësit e tjerë janë:
glicerinë, sukrozë, etanol 96%, metilhidroksibenzoat (nipaginë) dhe ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Kuti kartoni që përmban një shishe qelqi të errët me 100 g shurup.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

+18 Mosha e përdorimit mbi 18 vjeç.

Kujdes me dozimin. Mos merrni më shumë se doza e treguar në tabelë ose doza që ju ka përshkruar mjeku.

Përmbajtja. Kujdes. Shurup.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAH) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel./Fax: 00355 4 23 62 800
Tiranë - Albania

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Maj 2014.

SPECIFICATION CROPING AREA 15 X 25 cm